



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Datë: 29 Shtator 2025.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), neni 17 pika i) dhe neni 40 pika l) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, datë: 04. Qershor 2008, në bazë të nenit 7 dhe neni 77 paragrafi 2, të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-41341 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës, në propozim të kryetarit të komunës, në takimin e mbajtur me datë: **29 Shtator 2025**, nxjerrë këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

- I. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Pejës me aprovimin e kësaj deklarate shprehin mbështetjen e plotë për “Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike”, deklarata kjo e mbështetur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës më datë 19 nëntor 2024, si dhe është nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.
- II. Me këtë deklaratë Kuvendi i Komunës së Pejës mbështet pa rezervë edhe komunikatën mbështetëse të datës 16 Korrik 2025 të nënshkruar nga një numër i anëtareve të Kuvendit në nivel regjional, të shoqërisë civile dhe disa institucioneve tjera publike në takimin e organizuar nga OSCE të mbajtur në Pejë.
- III. Me këtë deklaratë besojmë të krijohet një front i përbashkët për ti dhënë fund dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
- IV. Kjo deklaratë hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

1x1. MAPL.

1x1. Kryetarit të Komunës.

1x1. Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj